



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Ne bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe të nenit 9.1 dhe 38.1 shkronjat a,b dhe c të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr.12479 dt. 21.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.04.2011, miraton këtë

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01.Nr.5817 PËR SHPALLJEN ZONË ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK TË NGASTRAVE KADASTRALE Nr.1961-1 DHE Nr.1961-2

I

Paragrafi I i vendimit 01.Nr.5817 i datës 26.05.2009, ndryshon dhe në të thuhet:

„Me këtë vendim, shpallet Zonë me Interes të përgjithshëm publik, ngastra kadastrale P-70403013-**01961-1**, zona- urbane, shfrytëzimi aktual- tokë bujqësore, vendi i quajtur „Fidanishte“, me sipërfaqe 9798 m²; ngastra kadastrale P-70403013-**04961-2**, zona- urbane, shfrytëzimi aktual- tokë bujqësore, vendi i quajtur „Fidanishte“, me sipërfaqe 3666 m²; ngastra kadastrale P-70403013-01964-3, zona- urbane, shfrytëzimi aktual- tokë e ndërtimit, vendi i quajtur „Fidanishte“, me sipërfaqe 161m²; ngastra këto me sipërfaqe të tërësishme 13625 m² që evidentohen në Çertifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-70403013-1730, Zona Kadastrale – Gjilan, në emër të P.SH. Kombinati Bujqësor Industrial, si dhe ngastrat kadastrale P-70403013-01961-10, zona – urbane, shfrytëzimi aktual- tokë e ndërtimit, vendi i quajtur „Fidanishte/ Pjesa e re“, me sipërfaqe prej 72 m² dhe P-70403013-01961-3, zona – urbane, shfrytëzimi aktual- tokë e ndërtimit, vendi i quajtur „Fidanishte/ Pjesa e re“, me sipërfaqe prej 1620 m², të cilat kanë sipërfaqe të tërësishme 1692 m² dhe evidentohen në Çertifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-70403013-09274, Zona Kadastrale-Gjilan, në emër të N.SH. Mekanizmi Prishtinë.

Sipërfaqja e tërësishme e ngastrave që shpallen Zonë me Interes të përgjithshëm publik është 15317 m² (1,5317 ha)“.

II

Ky vendim do të jetë pjesë përbërse e vendimit 01.Nr.5817 të 26.05.2009.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

Nr.01. 5684

Gjilan, më 27.04.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues